

# ANALIZË E SHKURTËR

Autor:  
**Artan Krasniqi,**  
sociolog dhe  
gazetar i kulturës

## PËRMBAJTJA

- Hyrje
- Çka shkoi ters?
  - Arsyet indirekte
  - Arsyet direkte
- Ndikimi i Serbisë
- Përfundim
- EC Ma Ndryshe



Organizata Jo-qeveritare  
Emancipimi Civil Ma Ndryshe

Saraçët 5, 20000/Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza,  
H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org  
info@ecmandryshe.org  
038-224-967  
029 222 771

Përkthimi në anglisht:  
Iliriana Kaçaniku

# ÇKA SHKOI TERS ME ANËTARËSIMIN NË UNESCO

Prill 2016, Prishtinë

## Hyrje

Në nëntorin e vitit të kaluar (2015), Kosova dështoi që të anëtarësohet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë - UNESCO. Ishte dështimi më i madh i shtetit të ri në diplomaci dhe në politikën e saj të jashtme. I erdhi kjo pas një serie të fitoreve në arenën ndërkombëtare, dhe 111 njohjeve nga vendet e ndryshme të botës. Por çka ndodhi? Ku çaloi Kosova? A ishte më shumë humbje e Kosovës apo fitore e Serbisë?

Kjo analizë e shkurtër, synon t'i përgjigjet disa pyetjeve për atë se çfarë ndodhi në "rrugëtimin e parë të Kosovës" drejt UNESCO-s, të tregojë se çka në të vërtetë shkoi keq, teksa ka për qëllim që duke identifikuar gabimet të propozohet që të njëjtat mos të përsëriten më. Synon gjithashtu që të japë një propozim se çka do të mund të bëhej ndryshe, kurdo që Kosova vendos të ripërsëritë kandidimin për në këtë organizatë të rëndësishme botërore.

Mbetet pjesë e debatit nëse Kosova duhet të tentojë anëtarësimin në rastin e parë të ardhshëm. Çka nëse dështohet prapë? Në fakt, një mori pyetjesh duhet shtruar para se të merret vendimi përfundimtar, dhe një është fundamentale: Çka ndryshoi në Kosovë në shkencë dhe në kulturë brenda periudhës përkatëse, që do t'i bënte anëtarët e UNESCO-s të ndryshonin qëndrimin pro Kosovës? Mos-anëtarësimi i Kosovës në UNESCO ka qenë dështimi më i madh diplomatik i saj që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008. Shteti i ri nuk e ka luksin e dështimit të dytë!



Kjo analizë është përgatitur për Forumin 2015 në kuadër të projektit "EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse", i përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim i përkasin autorit dhe organizatës jo-qeveritare EC Ma Ndryshe.



### Arsyet indirekte

- **Mungesa e njohjeve të reja**

Përkundër që Kosovën e kanë njohur 111 vende të botës, imazhi i përgjithshëm i Kosovës lë shumë hapësirë për përmirësim. Në kohën e udhëheqjes nga Hashim Thaçi, Minsitria e Punëve të Jashtme kishte siguruar vetëm dy njohje të reja. Fuqia ishte thënë se është orientuar në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare.

- **Gjykata Speciale**

Emri i Hashim Thaçi vazhdon të jetë i lidhur me "trafikim organesh" si krim lufte i përmendur fillimisht në raportin e asambleistit të Këshillit të Europës Dick Marty, e më pas në media me renome ndërkombëtare. Kosova i ka hapur rrugë krijimit të Gjykatës Speciale, Presidentja ka ratifikuar marrëveshjen me Holandën për Dhomat e Specializuara në Holandë, por Gjykata, që Kosova pret që ta pastrojë përfundimisht luftën e UÇK-së, ende nuk ka nisur punën.

- **Skandalet diplomatike**

Në përgjithësi diplomacinë kosovare e kanë përcjellë shumë skandale. Punësim i familjarëve dhe militantëve partiakë të partnerëve të koalicionit qeverisës, sjellje skandaloze e joprofessionale të stafit diplomatik [rasti i Urtak Hamitit në Kroaci; fyerja e diplomatit ndaj qytetarëve në Slloveni; këmbët mbi tavolinë nga zyrtarja në Ambasadën e Kosovës në Zvicër derisa shërbente palët; njohjet e "dyshimta" nga Afrika; sulmi fizik i sekretares së parë në Ambasadën në Berlin, Fatmire Musliu ndaj ambasadorit të atjeshëm Vilson Mirdita; shkeljet e ambasadorit Shpend Kallaba në Bullgari me keqpërdorimin e mjeteve dhe shfrytëzimin e pasurisë shtetërore; tërheqja para kohe e duke mos i respektuar as procedurat i ambasadorit në Japoni, Ahmet Shala; akuza për ngacmim seksual të grave japoneze nga një anëtar i stafit atje...]

- **Ngërçi politik**

Edhe kur ka nisur aplikimin në UNESCO, por edhe tani Kosova vazhdon të ketë probleme të brendshme politike. Partitë politike në pushtet dhe ato në opozitë nuk po gjejnë gjuhë të përbashkët në kapërcimin e ngërçit që po e shoqëron vendin. Kjo lë shije të keqe teksa shpërfaq paqëndrueshmëri politike për shtetin. Është konsideruar gabim mosmbajtja e diplomacisë bilaterale me shtetet që e kanë njohur pavarësinë. Qeveria është mjaftuar me njohjen e një vendi dhe nuk ka mbajtur kontakte diplomatike me shumë nga ato vende.

- **Votat e befasishme**

Vendimi përfundimtar për Kosovën ishte 92 vota pro, 50 kundër e 29 abstenime. I duheshin vetëm edhe tri vota për të kaluar. Në mesin e atyre që nuk votuar pro ishin edhe tri shtete mike të Kosovës, si Polonia, Japonia dhe Koreja e Jugut – shtete që e kanë njohur pavarësinë. Për raportet e Kosovës me Japoninë u përmendën disa shembuj më sipër, ndërsa Polonia ishte në mesin e shteteve që e kanë njohur Kosovën e ajo s'ka çuar ambasador atje.

### Arsyet direkte

- **Paqartësi rreth aplikimit**

Gjatë vitit të kaluar fillimisht u fol se aplikimi do të bëhej përmes UNMIK-ut dhe se përgatitjet kishin nisur në këtë drejtim. Ndërkohë doli në pah alternativa e dërgimit të aplikacionit përmes shtetit të Shqipërisë, për shkak të vështirësive burrokratike të rrugës përmes UNMIK-ut. Përfundimisht u vendos që Kosova të aplikojë e vetme, pa ndërmjetësim. Të gjitha këto paqartësi dhe ndryshime brenda një kohë jo të gjatë tregonin për mungesë të strategjisë paraprake. Kosova po i hynte një aventure pa vlerësim të mirëfilltë paraprak.

### ● “Hop pa kërcy”

Që kur kishte nisur rrugën për anëtarësim në UNESCO, në korrik të vitit 2015, boom-i mediatic e “propagandues” kishte qenë i madh. Ndonëse drejtuesit e procesit po e quanin si “betejë të vështirë”, Kosova po e merrte gati si punë të kryer anëtarësimin, sidomos pas kalimit në Këshillin Ekzekutiv, në tetor të 2015. Drejtues të shtabit lobues të angazhuar në proces madje ironizonin me ata që dyshonin në aftësitë e tyre se Kosovën nuk do të mund ta anëtarësojnë në UNESCO. Rrjetet sociale të ministrit të jashtëm Hashim Thaçi e zëvendësit të tij, Petrit Selimi, jepnin shpresë. Nga ana tjetër të dy kanë krijuar përshtypjen se do të kapitalizonin “këtë sukses në ardhje”.

### ● Privatizimi dhe Heshnja

Lajmi negativ e heshti Kosovën dhe akterët që u morën direkt me këtë çështje. Kur e gjithë fushata gati njëvjeçare ra poshtë, askush nga Ministria e Punëve të Jashtme nuk e mori barrën e përgjegjësisë. Në vend të llogaridhënies, kreu i diplomacisë së Kosovës, Hashim Thaçi, humbjen e trajtoi si fitore, duke u thirrur në cilësinë e votave (92 gjithsej, nga 95 sa duheshin), ani pse qëllimi nuk ishte arritur. Ishte pikërisht Ministria e Punëve të Jashtme dhe krerët e saj që në njëfarë mënyre kishin privatizuar të gjithë procesin, jo vetëm në deklarinimin publik për gjithë këtë rrugëtimin. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë as që deklaroheshin për këtë “betejë”.

### ● Mungesa e koordinimit

Gjatë gjithë këtij procesi ka munguar një koordinim më i mirë i të gjithë akterëve institucionalë dhe jo vetëm. Është parë një përfshirje jo e mjaftueshme e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, pastaj e institucioneve të tjera si Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Universiteti i Prishtinës, Institutet e ndryshme të trashëgimisë kulturore dhe të shkencës, e të tjerë. Ka munguar përfshirja e më shumë palëve të shoqërisë civile në hartimin e një strategjie të qartë të lobimit dhe përgatitjes së terrenit për anëtarësim të sigurt.

### ● Lobimi i dobët

Lobimi i Kosovës për UNESCO ka qenë më shumë teknik e politik, madje në margjina të objektit në Francë dhe i bazuar më shumë në përkrahjen e miqve, se sa që ka qenë përmbajtësor i bazuar në ofertë të Kosovës për mbrojtje të trashëgimisë kulturore e përparim të shkencës. Edhe pjesa politike e lobimit ka pasur mangësi serioze, ndërsa një nga veprimet e pakuptimta në këtë drejtim ka qenë edhe paraqitja e biznesmenit kosovar Behxhet Pacolli në ndërtesën e UNESCO disa ditë para seancës së votimit. Edhe ato pak veprime të ndërmarra nga Kosova ishin më shumë reagime ndaj veprimeve të Serbisë, se sa iniciativa të menduara mirë të lobimit.

### ● Shpresa te miqtë

Shumica e votave pro anëtarësimit të Kosovës u janë konfirmuar shteteve mike dhe jo drejtpërdrejtë Kosovës. Të dhënat flasin se krejt pak shtete u kanë dhënë mbështetje zyrtareve kosovarë që kanë lobuar gjatë nëpër korridoret e godinës së UNESCO-s në Paris. Zëvendëskryeministrit Hashim Thaçi i është konfirmuar vetëm një votë nga Ishujt Solomon. Po ashtu, sipas dokumentit qeveritar presidentes Atifete Jahjaga i është konfirmuar vetëm një votë pro nga Republika e Afrikës Qendrore. Por, në votim ky vend ka abstenuar. Ndërkohë zyrtarë që e kanë udhëhequr procesin, si argumentin më të fuqishëm kanë përmendur përkrahjen e shteteve mike, deri në garanca të shteteve të fuqishme për përfundim të suksesshëm të procesit të anëtarësimit.

### ● Pa diplomaci kulturore

Fushata e Kosovës për anëtarësim në UNESCO, ka nisur vonë. Kanë munguar aktivitete (promovim i dokumentarëve, fakteve, librave) që do të ndihmonin në këtë proces. Janë përfshirë vonë disa emra eminentë, si Inva Mula e Rita Ora, por do të mund të përfshiheshin edhe shumë emra të tjerë të njohur që vepronë jashtë. Diplomacia kulturore ka qenë pothuaj tërësisht e anashkaluar dhe shumë emra të njohur të artit që jetojnë jashtë nuk janë ftuar të kontribuojnë.

### ● **Materialet e (pa)përgatitura**

Ministria e Punëve të Jashtme sikur ka privatizuar edhe krijimin e materialeve për lobim. Duke dashur që të tregohet afirmative në qasjen e saj, ka injoruar fakte të rëndësishme të së kaluarës. Përveç kësaj, janë shtypur fletushka në të cilët është shpërfaqur Hashim Thaçi, Petrit Selimi e një riprodhim i kohëve të fundit i Hyjneshës në Fron, me përmasa gjigante, pa kurrfarë vlerash arkeologjike e historike. Në fakt nuk do duhej të jetë fare punë e MPJ-së krijimi i katalogëve. Për këtë do duhej përfshirë ekspertët.

### ● **Trashëgimia kulturore e degraduar**

Kosova ka një legjislacion të mirë për fushën e trashëgimisë kulturore, por si në shumicën e fushave çalon në zbatimin e saj. Shumë objekte të trashëgimisë kulturore vazhdojnë të shkatërrohen para syve të shtetit. Shumë mekanizma janë jofunksionale (Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është funksionalizuar disa vjet pasi që është themeluar, teksa ka mungesa të mëdha të kuadrit profesionist në Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore). Ende nuk ka mbrojtje të përhershme të pronave të trashëgimisë kulturore. Mungon një qasje më aktive e promovimit të turizmit kulturor dhe e pasqyrimin të diversitetit kulturor të Kosovës. Monumentet e vendit nuk i njohin mirë as vetë kosovarët. Institucionet në përgjithësi janë treguar të ngathëta për të promovuar ato në botë. Shumicës së objekteve u mungon shenjëzimi adekuat. Në tërësi menaxhimi i trashëgimisë kulturore lë shumë për të dëshiruar.

### ● **Anashkalimi i shkencës dhe edukimit**

Një tjetër problem është që gjatë aplikimit të saj të parë për UNESCO, energjia është fokusuar më shumë në drejtim të trashëgimisë kulturore, duke lënë anash edukimin dhe shkencën, si komponentë tejet të rëndësishëm të kësaj organizate. Për më tepër, nuk janë analizuar me dhjetëra programe të UNESCO-s jashtë trashëgimisë kulturore, për të promovuar përparësinë konkurruese të shoqërisë dhe shtetit kosovar.

### ● **Fushata e ashpër**

Për dallim prej fushatës së Kosovës, ajo e Serbisë ka qenë e ashpër. Për të ishin koordinuar institucione shtetërore, fetare e akademike. Kishte nisur fushata "Jo Kosova në UNESCO". Politikanët lobonin jo në margjina, por përmes ambasadave e zingjirit të tyre diplomatik për vota kundër Kosovës. I shkruanin letër kujtudo që e konsideronin të rëndësishëm për të penguar procesin. Ban Ki-moonit ia kujtonin se "Kosova si territor, ashtu siç e paraqet Rezoluta e plotfuqishme dhe e detyrueshme 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, është nën administrim të Kombeve të Bashkuara dhe në këtë kontekst nuk mund të konsiderohet shtet - subjekt i së drejtës ndërkombëtare e me këtë nuk mund as të kualifikohet për t'u pranuar në UNESCO". E Kosovën dhe kosovarët po i krahasonin me ISIS-in e terroristët, vetëm për një mbishkrim që nuk dihej saktë kush e ka bërë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë kishte shkruar letër simotrave gjithandej botës me të cilën thoshte se po dëshmon rrezikun e ndryshimit të çdo konteksti të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Serbia vazhdonte traditën e propagandimin teksa thirrej në historinë, që faktografia materiale dhe e shkruar e njej si të falsifikuar. Ati Sava Janjiç, kërkonte që të shtyhet aplikimi i Kosovës, "derisa Beogradi dhe Prishtina në dialogun e sponsorizuar nga Brukseli të finalizojnë qartë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e kishave tona në Kosovë me të gjitha garancitë ndërkombëtare", teksa thoshte se "kjo duhet të ndodhë në mënyrë që ne të shmangim që kishat tona të bëhen pre e sulmeve nacionaliste pasi legjislacioni aktual në Kosovë nuk është mjaft i qartë dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve të njëanshme". Thirrej në shkatërrimin e 34 objekteve të Marsit 2004. Përtej kësaj, Serbia kishte kërkuar "front të gjerë të krishterë kundër Kosovës". Politika e jashtme dhe e brendshme e Kosovës pothuajse injoroi tërësisht këtë fushatë të Serbisë.

## ● Shkelja e Marrëveshjes

Pengesat që po i bënte hapur Serbia Kosovës në rrugën drejt anëtarësimit në UNESCO po ndodhnin pasi që palët janë dakorduar në Bruksel për fqinjësi të mirë e normalizim marrëdhëniesh. Në pikën e 14-të të marrëveshjes së 19 prillit të vitit 2013 fillimisht palët kishin diskutuar për mundësinë që mos ta pengojnë njëra-tjetrën në anëtarësimet e tyre në organizatat ndërkombëtare, që i bie edhe anëtarësimin e Kosovës në OKB. Por një gjë e tillë nuk ishte pranuar nga Serbia. Tani në pikën 14 të marrëveshjes, thuhet se “është arritur pajtimi që asnjëra palë të mos bllokojë, as të inkurajojë të tjerët për bllokimin e përparimit të palës tjetër drejt rrugës për në BE”. Megjithatë, pengesa që Serbia i ka bërë Kosovës në rrugën drejt UNESCO-s nuk ka mbetur pa u kritikuar. Por kaq. “Rasti i UNESCO-s vë në dilemë se sa i suksesshëm është ky dialog. Sepse veprimet e Serbisë përball përpjekjes së Kosovës për në UNESCO, nuk ka qenë në frymë të mirë. Përkundrazi, disa përfaqësues qeveritarë të Serbisë kanë shfaqur një nivel të lartë të urrejtjes, e cila është shumë kundërthënëse me atë që përfaqësuesit serbë e tregojnë kur ulen në tryezë me përfaqësues qeveritarë të Kosovës. Zbatimi kupton zbatimin e çdo gjëje që palët janë pajtuar”, kishte thënë Ulrike Lunaçek në një intervistë për mediat në Beograd.

## ● Bisedime të reja

Serbia është e interesuar që ta rikthejë çështjen e “trashëgimisë kulturore” në bisedimet me Kosovën që po vazhdojnë të mbahen në Bruksel, me lehtësimin e BE-së. Serbia do që të shkojë përtej Anexit 5 të Pakos së Ahtisarit, që do të ofronte avancim edhe më të madh të këtij institucioni fetar, edhe ashtu tejet të favorizuar. Me këtë, synohet shkëputja e tërësishme nga ligjet e Kosovës, duke shkëputur edhe zyrtarisht komunikimin dhe kështu të krijohet një realitet të ri politik e juridik në vend, që do të nënkuptonte një entitet totalisht të pavarur, ose një lloj “shteti brenda shtetit”.

## ● Katër monumentet ortodokse

Fitorja e parë e Serbisë në raport me monumentet e Kosovës kishte qenë në vitin 2006, kur kishte arritur t'i fusë si të saj katër monumente brenda Kosovës (Patrikanën e Pejës, Kishën e Shën Premtes, Manastirin e Deçanit dhe atë të Graçanicës) në Listën Botërore të UNESCO-s. Pa e pyetur fare Kosovën dhe duke shkelur ligjet e saj, Patrikanës së Pejës i ishte ndryshuar pamja e jashtme, në vazhden e tentimit për tjetërsim të historisë. Pamja e saj bizantine i kishte humbur!

## ● Fatura e Marsit 2004

Shteti i Kosovës, ndonëse e ka paguar rëndë financiarisht faturën e trazirave të Marsit 2004, vazhdon ta paguajë ende këtë faturë në aspektin diplomatik e propagandues të Serbisë. Rreth 6 milionë euro të taksapaguesve kosovarë janë investuar në monumentet e trashëgimisë ortodokse, janë ngritur 200 akuza kundër protestuesve, prej të cilëve 143 persona janë dënuar me burgim. Madje 67 prej tyre kanë marrë dënim me burg mbi një vit, e ka raste të dënimit deri në 16 vjet. Pa tentuar justifikimin e atyre veprimeve, duhet cekur se shteti i Kosovës atëherë dhe tash ka qenë i distancuar nga këto trazira.

## ● Dëmet e luftës 1998/99

Në anën tjetër, askush nuk i përmend shkatërrimet e Serbisë në trashëgiminë kulturore në Kosovë. Në kohën e luftës së fundit, 1998/99, janë djegur rreth 220 xhami, shumica e të cilave ishin të ndërtuara në kohën e Perandorisë Osmane. U shkatërruan çarshitë e vjetra në Pejë, Gjakovë e Vushtrri, pastaj u dogjën biblioteka, arkiva e mejtepe. U shkatërruan shtëpi-kulla me vlera monumentale. Veç kësaj, Serbia vazhdon të mbajë në Beograd 1243 artefakte arkeologjike e etnologjike të Kosovës, të cilat i mori nga Muzeu i Kosovës kur po tërhiqej me ushtri e administratë në qershor të vitit 1999. Vetëm “Hyjnesha në fron” është kthyer në vendin e origjinës. Kosova vendosi të mos i përmend fare këto fakte në lobimin e saj për në UNESCO, ani pse ato i bëri aparatit shtetëror serb i kohës.

Kur kemi kryer tremujorin e parë të vitit 2016, ende nuk ka një vendim të qartë nëse Kosova do t'i kthehet menjëherë në vitin e ardhshëm procesit për anëtarësim në UNESCO. Kjo, me gjasë, do të varet nga vullneti politik i Ministrisë së Jashtme në Qeverinë e Kosovës. Mbetet pjesë e debatit nëse Kosova duhet të tentojë anëtarësimin në rastin e parë të ardhshëm. Çka nëse dështohet prapë? Në fakt, një mori pyetjesh duhet shtruar para se të merret vendimi përfundimtar, dhe një është fundamentale: Çka ndryshoi në Kosovë në shkencë dhe në kulturë brenda periudhës përkatëse, që do t'i bënte anëtarët e UNESCO-s të ndryshonin qëndrim pro Kosovës?

Sidoqoftë, kurdo që vendosë ta bëjë këtë duhet të ketë parasysh disa aspekte:

- Të punojë në përmirësimin e imazhit të Kosovës në botë. Skandalet e kaluara duhet të rikuperohen, dhe nuk duhet lejuar përsëritja e tyre.
- Të garantojë se është e gatshme që të mbrojë trashëgiminë e saj kulturore, përfshirë edhe atë ortodokse. Për këtë, të gjithë dëmtuesit e trashëgimisë kulturore duhet të marrin dënimin e paraparë me ligj.
- Procesi i aplikimit në UNESCO nuk guxon të privatizohet nga njëra apo tjetra ministri. Në proces duhet të përfshihen më shumë akterë; ekspertë, pjesëtarë të shoqërisë civile.
- Kosova duhet ta ketë një platformë të përbashkët veprimit, me përfshirjen e të gjithëve dhe përgatitjet për aplikimin e radhës të fillojnë prej tash.
- Lobimi nuk duhet të jetë vetëm teknik e politik, por edhe përmbytësor, me materiale të përgatitur mirë, bazuar në fakte e argumente historike.

- Fushata agresive e Serbisë, e cila vazhdon edhe sot, nuk duhet të mbetet pa kundërpërgjigje. Kosova ka mjaft argumente për t'i rrëzuar këto manipulime, që të vetmin qëllim kanë bllokimin e anëtarësimin të Kosovës dhe asesi mbrojtjen e përnjëmendte të pronave të Kishës Ortodokse në Kosovë.

**Mosanëtarësimi i Kosovës në UNESCO ka qenë dështimi më i madh diplomatik i saj që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008. Shteti i ri nuk e ka luksin e dështimit të dytë!**



Organizata Jo-qeveritare  
Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes).

Tiparet dalluese të EC janë: një, fokusi gjeografik, dhe dy, qasja ndaj çështjeve të interesit. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet e hulumtimit të organizatës ofrojnë përmbajtje të besueshme, pasi që merren me thelbin e problemit në vend se me simptomat. Për më tepër, EC mbulon fusha të veçanta sikur planifikimi urban, politikat kulturore, menaxhimi i hapësirës publike dhe të ngjashme, të cilat janë përgjithësisht të nëntrajtura në Kosovë. Aktiviteti hulumtues dhe aktivizmi grassrootsi organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvarura. Përmes aktivizmit, EC angazhohet në mënyrë të përhershme në punë me grupet e komunitetit për t'i identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burime që e ushqejnë komponentën e hulumtimeve. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh tek agjenda e politikëbërjes, pasi që idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht krijohen mundësi për përfshirjen e politikëbërësve në një debat konstruktiv dhe të mirëinformuar.

Projektet kryesore të organizatës gjatë viteve të fundit: Prizreni, qytet pa pengesa (2016–2017), Qyteti Gjithëpërfshirës, lagje aktive për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2016–2020), Shkolla për Planifikim dhe Zhvillim Urban (2015–2016), EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse (2015–2016), Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale (2015–2016), Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013–2016), Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014–2015), Qyteti Gjithëpërfshirës, planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013–2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014–2016), Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor (2014–2015), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale (2013–2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit lokal dhe rajonal në Prizren (2013–2015), Pjesëmarrja publike në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2012–2013), Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012–2015), Një tregim ballkanik (2011–2012), Aktivizmi qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (2009–2010).

Publikimet e fundit të organizatës: Trashëgimia kulturore, një histori e patreguar (2016), Milionat e shpenzuara për monumentet e mbyllura (2016), Një qytet për komunitetin (2015), Katalogu i Rajonit Jug “Bukur dhe Gjellbër” (2015), Zhdukja e Gjurmëve – Qendrat historike të Kosovës (2015), Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore (kontribut për raportin e Progresit) (2015), (Pa)drejtësia në urbanizmin e Prizrenit (2015), Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren (2015), Katalogu i Rajonit të Prizrenit (2015), Planifikim urban për qytetarët (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Ku është kalldrëmi i Prizrenit? (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Udhëzues për transparencën në komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014).